



### PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **31.1.2025**, me fillim në orën **10:10**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**. Në fillim kryesuesi konstatoi kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 31 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 24.

**Kryesuesi:** Përshëndetje për të gjithë! I nderuari kryetar i Komunës, **z. Smajl Latifi**, nënkryetar **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit! Për këtë mbledhje të **parë** të vitit 2025, së bashku me kryetarin, kemi vendosur për këtë rend dite:

### REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e komunës së Rahovecit, për vitin 2025;
4. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar janar – dhjetor 2024;
5. Shqyrtimi i raportit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2023;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, P-05864-0 dhe 05865-0, ZK – Rahovec;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës P-05864-0 dhe 05865-0 ZK Rahovec;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, P-00597-6, ZK – Xërxë;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës P-00597-6, ZK – Xërxë;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për këmbimin e pronave komunale me pronat e institucionit qendër;
11. Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024;
12. Shqyrtimi i informatës rreth punës së KKSB-së për vitin 2024;
13. Shqyrtimi i raportit të punës së këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2024;
14. Shqyrtimi i raportit vjetor rreth punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024;
15. Shqyrtimi i planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025;
16. Shqyrtimi i raportit të punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2024;
17. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2024;

## **Shtesë:**

- 1. Vendimi për formimin e komisionit përzgjedhës për plotësim-ndryshimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.**
- 2. Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajshme për rastet e veçanta - Ministria e Ekonomisë.**

**Kryesuesi:** Të nderuar anëtarë të Kuvendit, fillimisht pika e 10-të duhet të hiqet nga rendi i ditës dhe të zëvendësohet me një tjetër pikë shtesë, të cilën do ta shpjegojë drejtori Afrim Oruqi. Vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajshme për rastet e veçanta.

**Afrim Oruqi:** Faleminderit, kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, të nderuar anëtarë të kuvendit. Bazuar në kërkesën zyrtare të Ministrisë së Ekonomisë, MAPL-së dhe Ministrisë së Financave, kërkoj mirëkuptimin e juaj, për shkak të afateve të përcaktuara dhe që kontrata të zbatohet, kërkojmë nga ju që të tërhiqet pika e dhjetë, që ka të bëjë me këmbimin. Ka ardhur edhe një shkresë, të cilën e keni në material edhe ju. Më datë 24 janar 2025, nga ministrja Artanë Rizvanolli. Kryetari i komunës me ekipin e tij, bashkë me zyrën ligjore, në takime me këto tri ministri për ta shpëtuar këtë proces, i cili është investimi më i madh milionësh në komunën e Rahovecit, që nga paslufta dhe kërkojmë nga ju që ta vendosim në rend dite këtë pikë, që disa parcela të komunës që janë në këto dy zona, në Kramovik dhe Petkoviç, të marrim vendim që fillimisht t'ia japim në shfrytëzim Ministrisë së Ekonomisë dhe më pas, qeveria ka një marrëveshje me konsorciumin për parkun solar, e cila e jep në shfrytëzim për 34 vjet, me qëllim të vetëm që ata ta fillojnë projektin sipas procedurave dhe afateve ligjore. Kërkesa jonë është që t'i respektojmë kërkesat e ministrive përkatëse. Të marrim vendim për dhënien në shfrytëzim dhe pastaj t'ia japim në shfrytëzim ministrisë së ekonomisë për 34 vjet. Sipas marrëveshjes, projekti i implementimit të projektit të fillojë në muajin mars.

**Burim Krasniqi:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për ekzekutivin, kolegët asambleistë, monitoruesit, të gjithë të pranishmit. Në një pikë që ka qenë për dhënien në shfrytëzim të lokaleve të stacionit të autobusëve është thënë që, shfrytëzuesi nuk ka të drejtë t'ia jep në shfrytëzim palës së tretë. A do të shfaqë problem edhe kjo në këtë rast, nëse je ia japim ministrisë e ministria operatorit? Nuk hezitoj a duhet ta përkrahim apo jo, sepse duhet ta japim në shfrytëzim, por, a na shfaqë problem proceduralisht?

**Afrim Oruqi:** Në takimin e djeshëm të tre palëve dhe në monitorim të Usaid-it, MAPL, Ministria e Financave, sektori për vlerësim të pronës dhe Ministria e Ekonomisë, kanë marrë përsipër dhe kanë garantuar që nëse ky vendim merret sot, shkon sot për ligjshmëri dhe ligjshmëria vjen të hënën – të martën.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Pika tjetër shtesë ka të bëjë me vendimin për formimin e komisionit përzgjedhës për plotësim-ndryshimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara. Atëherë, këto dy pika shtesë i vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Me shumicë votash (20), votohen pikat shtesë. Tani e vendosim në votim rendin e ditës të plotë. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash (20), votohet rendi i ditës për mbledhjen e parë të rregullt të kuvendit.

### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:**

**Kryesuesi:** A ka dikush ndonjë gjë rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Konstatoj që me shumicë votash (20), votohet edhe pika e parë e rendit të ditës.

### **2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve:**

**Burim Krasniqi:** Përshëndetje edhe një herë për të gjithë të pranishmit. Fillimisht, kërkoj mirëkuptim që të jemi më të shkurtër në diskutimet tona. Ata që do t'i kenë raportet të jenë më të shkurtër, mos të na marrin shumë kohë, sepse jemi në fushatë zgjedhore. Po flas si kryetar i LDK-së. Në pyetjet që i kam, nuk kërkoj përgjigje aty për aty. E para për drejtorin e kadastrës. Një vendim që është lëshuar për historiatin e parcelave, është lëshuar prej vitit 60', mirëpo tjetërsimi i parcelave ka ndodhur diku rreth 56'- 57'. Historiati për parcela të lëshohet prej periudhës kur ka historiati komuna, ose nëse ka pengesa ligjore të lëshohet për parcelë, të lëshohet për trashëgiminë familjare – trungun familjar. Një kërkesë e kam për kryetarin: Në kohën e pandemisë kur është rritur çmimi i peletit, operatori ekonomik ka kërkuar të tërhiqet për

shkak të kostos së lartë. Një përgjigje që e kam marrë nga drejtori i Arsimit, për çmimin e peletit prej 370€, që gjatë tenderimit ka qenë çmimi i lartë e më pas ka ra, ju kërkoj zyrtarisht që ta ndërprisni kontratën. 270€ është 80% më shtrenjtë se çmimi real i tregut. Te orët e humbura në matematikë, është sfiduese, por është mirë ta gjeni një zgjidhje dhe t'u kompensohen, sepse klasat e nënta në Hoçë të Vogël nuk janë duke mbajtur matematikë që disa ditë. Gjendje e njëjtë është edhe në gjimnaz në Rahovec. Është sfiduese, por së paku një inxhinier ose një student ta ofroni dhe që orët mos të humben. Te drejtori i Financave, rreth raportit të ZKA-së për të gjeturat e 20%-it të poentimit, është hera e katërt që po e kërkoj përgjigjen. Listimin e operatorëve sipas ofertave. Të lutem drejtor, ta kem me shkrim një përgjigje se si ka qenë kjo punë.

**Sejfullah Sejfullahu:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje kryetar, nënkryetar, drejtorë, asambleistë. E kam një pyetje për Përparimin në lidhje me pastrimin e rrugëve në fshatin Krushë e Madhe. Para një viti kemi biseduar dhe keni thënë që do ta shpeshtoni pastrimin. Unë nuk e di si është kontrata, por kam informata që pastrimi i rrugëve në Krushë është 4 herë në muaj. Në bazë asaj që di unë, aty janë pastruar rrugët vetëm me 17 shkurt dhe 25 mars. Rrugët kanë nevojë për pastrim, sidomos ajo pjesa ka varrezat. E dyta, më keni premtuar që do ta gjeni një formë t'i shtroni disa rrugë dhe pse janë anuluar disa që kanë qenë në plan të bëhen? Është shumë keq ajo rruga "Dellova" të shtëpia-muze. E kemi një krenari në aty, Lumbardh Dellovën, i cili më tha "O baca Sefë, e shtron kryetari. I kam edhe 7-8 ankesa, por pas fushatës.

**Fahrije Lushi:** I nderuar kryesues, kryetar, kolegë këshilltarë dhe të gjithë të pranishmit. Sot, po e ngre përsëri çështjen e kanalit të kullimit të tokave në Malësi të Vogël, çështje të cilën e kam ngritur edhe në mbledhjen e kaluar. Dua t'i drejtohem kryetarit, se sa është në rregull nga ana juaj që toka ka qenë e mbjellë me grurë dhe ju për tre vite radhazi e keni pas këtë mundësi për t'i zhvilluar punimet në atë kanal. Tani ju keni filluar punimet aty, duhet e dëmtuar tokën. Shqetësimi i qytetarëve është që pjesën kryesore të kanalit të kullimit nuk e keni punuar, rreth 100m dhe pikërisht aty është problemi kryesor i atyre tokave punuese. Këto toka, vërshohen prej atij kanali sa herë që ka të reshura. Kam kërkesë prej qytetarëve që të gjeni mundësinë dhe të punoni pikërisht në gjatësinë tjetër që e ceka më lartë.

**Bejtullah Deliu:** Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, zëvendëskryetar, drejtorë, kolegë asambleistë, media, të pranishëm. Nëse keni mundësi ta gjeni ndonjë zgjidhje edhe pse kjo gjë është sfiduese edhe në nivel Kosove, fjala është për qentë endacakë. Personalisht kam hasur në 2-3 raste kur janë sulmuar fëmijët e vegjël, sidomos te ajo pjesa e sheshit qendror dhe parkut, si dhe te posta. E dyta, kemi probleme me punët që po i kryen Radoniqi, sidomos në rrugët kryesore, ka filluar ngecja në sanimin e gropave, në asfalt dhe në kubëza. Një kërkesë që e kemi bërë më herët te drejtoria e Arsimit, lidhur me pagesat e shujtave për kontratën kolektive dhe na patë thënë që, e kemi një komisioni, komisioni është duke analizuar çdo çështje. Keni thënë gjithashtu që do të raportoni, por ka një kohë të gjatë, më shumë se një vit dhe ende nuk keni raportuar.

**Lirigzon Kastrati:** Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të ekzekutivit, kryetar, kolegë anëtarë të kuvendit komunal. Në seancat paraprahe, me drejtorin e Urbanizmit kemi diskutuar për çështjen e rregullimit të shtratit të lumit dhe janë duke vazhduar punimet, por janë ndërprerë. Kur pritet të fillojnë punimet? Degëzimi që po bëhet aty brenda, një pjesë e kanalizimit të lagjes "Elshani" në Brestoc, a e keni përfshirë në projekt? Për drejtorin e Bujqësisë e kam një kërkesë të vazhdueshme të qytetarëve të fshatrave: Hoçë e Vogël, Brestoc dhe Nagac, rreth rrugëve fushore. Tri vite nuk është bërë asnjë investim dhe a keni paraparë që në këtë vit të bëhet diçka. Për Drejtorinë e Shëndetësisë, rreth funksionalizimit të AMF-ve. Disa janë duke punuar me gjysmë orari dhe a keni ndonjë plan të veprimit që këto AMF të funksionalizohen me orar të plotë.

**Eqrem Spahiu:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Një pyetje për drejtoreshën e Shëndetësisë, rreth punimeve në AMF-në e Opterushës dhe kur pritet të rifilloj punën AMF-ja aty.

**Defrim Kafexhiu:** Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, të nderuar kolegë anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë, zyrtarë komunalë, media. I kam disa pyetje dhe dua të ndërlihem me një thirrje për nivelin qendror dhe të gjithë mbështetësit e Lëvizjes Vetëvendosje, që e ka bërë drejtori i Gjeodezisë dhe Kadastrës, Afrim Oruqi.

Drejtori e ka përmend gjendjen e rrugëve nacionale, duke i përmendur pengesat ose gropat. Deri diku edhe unë pajtohem, por nëse kërkesa prej komunës së Rahovecit drejt niveli qendror, do të shkonte me kohë e jo në fushatë zgjedhore. Nëse rrugët janë në gjendje të keqe, atëherë komuna duhet të vazhdojë kërkesën drejt institucioneve qendrore për rregullimin e tyre. Dua ta pyes drejtorin se çfarë mendimi ka për gjendjen e rrugëve: “Mexhid Mustafa”, “Hadije Spahiu”, “Xhafer Nurkasa” dhe shumë rrugë tjera brenda qytetit që janë me gjendje të mjerueshme, e në anën tjetër komuna nuk e ka bërë asnjë hap për meremetimin e këtyre rrugëve që janë shtruar më herët. Dua ta përmendi edhe rrugën ku banon drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër, rrugën mbi xhaminë Sokoli, e cila gjithashtu është në gjendje të keqe dhe drejtori çdo ditë kalon nëpër atë rrugë që të vijë në komunë. Dua ta pyes nëse ka bërë ndonjëherë kërkesë që ajo rrugë të hyjë në rrugët që duhet të trajtohen për rregullim? Gjithashtu, rruga “Kullat Binjake”, është kjo rruga këtu, prej komunës që e ka daljen poshtë të “Gëzim Hamza”. Veturat zyrtare çdo ditë e kalojnë këtë rrugë, nuk është në gjendje të mjaftueshme, bile është në gjendje më të keqe se sa ato rrugët rajonale që i përmendi drejtori. Një pyetje tjetër, rreth kontratës për rregullimin e varrezave të martirëve. Ku është procesi i kësaj kontrate? Gjithashtu, dua të pyes edhe për çështjen e trafos të rruga “Vëllezërit Frashëri”, ku është procesi dhe pse nuk po rregullohet ende? Jemi me një sezonë ku konsumi i energjisë është më i lartë, shkak i dimrit dhe gjendja e çdo shtëpie në këtë lagje, sa i përket tensionit të energjisë elektrike është për t'u ardhur keq.

**Kryetari:** Përshëndetje kryesues, anëtarë të kuvendit, monitorues, media, drejtorë, nënkryetar. Do të jem i shkurtër. Trafoja është miratuar, KEDS-i e ka miratuar dhe shpresojmë që nuk do të vonohet. Është e vërtetë që ka rrugë lokale dhe rajonale me të cilat kemi probleme dhe duhet të themi që ne si komunë kemi projekte të mëdha të cilat nuk po na lënë të punojmë shumë. Sheshi po na merrë shumë para dhe janë 2-3 shkolla tjera që kushtojnë. Besoj që sivjet do të kemi mundësi të punojmë pak më shumë edhe në rrugë lokale dhe në ato rajonale. Kemi kontrata edhe për rrugë rajonale. Kontrata për rregullimin e varrezave ekziston dhe jemi në proces të finalizimit të emrave dhe të të dhënave të martirëve. Të hënën besoj që rifillon puna në QMF në Opterushë. Shtrati i lumit prej Hoçës së Madhe deri në Krushë të Madhe, do të përfshijë edhe aspekte shtesë që lidhen me kanalizimin që e përmendi Lirigzoni. Kemi kontratë gjithashtu edhe për rrugë fushore dhe kësaj radhe besoj që do të kemi veprime edhe në luginën e Brestocit, në Krushë të Madhe dhe në të gjithë komunën. Bejtullah, kontrata kolektive 2.1 milionë do të merren tani dhe shpresojmë që të merren nga kodi, paga dhe mëditje. Kjo do të thotë që procesi i ekzekutimit të pagesave, për përmbushjen e të drejtave të punëtorëve të arsimit dhe punëtorëve shëndetësorë është duke ndodhur. Qentë endacakë janë problem kompleks. Ne e kemi kontratën në përputhje me standardet që kërkohen sot. KRU “Gjakova” e dënojmë shpesh, por nuk jemi të interesuar ta dënojmë. Ka vonesa në sanimin e rrugëve kur ata punojnë. Te kanalet e kullimit, do të ishte mirë të kemi mbështetje nga niveli qendror, por nuk kemi. Ne e kemi një kontratë për Malësi të Vogël, ku kanë rifilluar punimet, mirëpo ka pasur një kërkesë prioritare që të trajtohet një problem në qendër, te oda e fshatit. Sefë, te larja e rrugëve dhe te kubëzimi i tyre: Këtu mund ta rishikojmë kontratën dhe jemi të interesuar të dimë nëse është në përputhje të plotë realiteti me kontratën. Te kubëzimi i rrugëve kemi kontratë edhe pse kemi vështirësi, sepse prej shtatorit nuk ka pasur prodhim të kubëzave në rajonin e Prizrenit. Besoj që me përmirësimin e kohës do të mundësohet edhe prodhimi i kubëzave dhe do të ketë aktivitete në rrugë. Burim, te historiat e parcelave, këtë temë mund ta trajtoni me drejtorin. Te orët e humbura, nuk ka profesor të matematikës. Jemi duke u mundur t'i bëjmë disa kombinime që mund të përshtaten. Te ndërprerja e kontratës, fillimisht ka qenë 600€, Peja e ka pasur 650€ një kohë. Me rritjen e çmimeve i kanë shkëputur kontratat në mënyrë të njëanshme për të përfutur. Ta shohim nëse ne mund të bëjmë shkëputje të njëanshme, ose miqësore me operatorin.

**Drilon Mustafa:** Përshëndetje për kryetarin, kryesuesin dhe drejtorët e drejtorive. Unë e kam një propozim për një parking të hapur mbi qendrën e regjistrimit të veturave. Tani që është duke u ndërtuar qendra e inovacionit dhe kulturës, aty është shfrytëzuar si parking dhe tani qytetarët kanë vështirësi për parking. Mbi qendrën e regjistrimit të veturave është një parcelë e komunës dhe me një investim të vogël do të krijoheshin mundësitë për parking.

**Merisa Sharku:** Përshëndetje për të gjithë! Kryetari e përmendi sheshin që po thith shumë fonde. Dëshiroj ta pyes se ku kanë mbërritur punët dhe si janë punët me financa. Pyetja tjetër: Pse kanë stagnuar punimet të “Grape City”?

**Kryetari:** Faleminderit Merisë! Tani është koha e dimrit, por kanë rifilluar punimet në sheshin qendror. Sa i përket financave, kemi financa dhe do të vazhdojmë me angazhim shtesë. Te “Grape city” me të parin rikthehet puna. Shkronjat veç janë të porositura.

### **3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e komunës së Rahovecit, për vitin 2025:**

**Nënkryetari:** Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të kuvendit, drejtorë të drejtorive, KFOR-i, media dhe të gjithë ju të pranishëm. Para vetes e kemi vendimin për mbulimin e shpenzimeve të varrimit. Të gjitha pikat janë të njëjta përveç shumës, e cila është ngritur nga 220 në 280€. Të bashkëngjitur e kemi edhe specifikacionin e shërbimit.

**Burim Krasniqi:** A ka skaduar vendimi paraprak, a është ende në fuqi? Nëse vendimi paraprak ka skaduar, është mirë ta vendosni një pikë që shpenzimet e varrimit në mes dy vendimeve të mbulohen retroaktivisht.

**Kryesuesi:** Faleminderit! Nëse nuk kemi diskutime të tjera, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Me shumicë votash (22), votohet pika e tretë.

### **4. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar, janar – dhjetor 2024:**

**Afrim Limani:** I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, asambleistë. Raporti financiar vjetor 2024, përfshin të gjitha ngjarjet dhe aktivitetet financiare të cilat janë zhvilluar në kuadër të komunës së Rahovecit. Ky raport përbëhet nga pjesa e të hyrave, pjesa e shpenzimit të buxhetit, pjesa e kontratave të lidhura, obligimet financiare dhe në fund janë edhe shpenzimet komunal. Do t’ju shpjegoj disa të dhëna bazike: Të hyrat në total janë 1.847.000€ dhe kur bëjmë krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kemi një rritje prej 57.815€. Këtu është fjala për të hyrat e rregullta, pa gjoba të gjykatave dhe të trafikut. Nëse i shtojmë edhe gjobat e gjykatave dhe të trafikut, atëherë janë 2.110.000€. Buxhetin kemi arritur ta shpenzojmë në total 22.638.000€ apo 99.24%. Raporti i ka të përfshira edhe të gjitha kontratat që janë lidhur në kuadër të zyrës së prokurimit. Pastaj, në raport i kemi obligimet financiare të kategorisë mallra dhe shërbim, si dhe obligimet e kategorisë së investimeve kapitale. Këtu janë të paraqitura kontratat e nënshkruara për vitin 2024 dhe në total janë 10.954.000€. Obligimet financiare që janë bartur nga 2024 në 2025, në total janë 1.114.000€.

**Burim Krasniqi:** Faleminderit drejtor! Dua të ndalem në pak pika. Te të hyrat, tabela 1.6 është diçka interesante: Taksa për regjistrim të automjeteve në 2023 janë 109.000, në 2024 janë 110.000, d.m.th njëjtë. Taksa rrugore, në 2023 janë 1230€, në 2024 – 10.325€. Për të hyrat përafërsisht të njëjta për regjistrimin e automjeteve dhe dallimi është 10-fish më i lartë. Këtë vit, gjoba të trafikut kemi 100.000€ më shumë sesa vitin paraprak. A ka shumë më shumë kundërvajtje?! Në tabelën 3.3, nëse nuk gaboju te zyra e kryetarit, shpenzimet e internetit për vitin 2024 vetëm 22€. Tabela 3.4, shpenzimet e udhëtimit brenda vendit janë të ndarë në tri pozicione. A mund të akomodohen vetëm me një pozicion? Është shqetësim që e kemi thënë vazhdimisht, që edhe Sinani si jurist e ka thënë dikur, shpenzimet e avokaturës prej vitit në vit po rriten! Në 2024 janë 8997€ më shumë sesa në 2023 dhe nuk ka ndonjë efekt. Shpenzimet këshillëdhënëse, në 2024 kanë rritje 100% në krahasim me 2023. Janë pyetje që nuk po të kërkoj përgjigje sot. Për konsulentë është ndarë një shumë prej 40.000€, sa persona janë dhe sa është paga e konsulentëve për këto shërbime. Është një pozicion, “shërbimet kontraktuese tjera” dhe vlera e tyre është rreth 392.000€. Kjo është vlerë e madhe dhe i bie nëse e krahasojmë me mallra dhe shërbime është rreth 15% e buxhetit total të kësaj kategorie buxhetore. Çështja e peletit në raport me 2023 është rritur me çmim 100%, sipas tabelës 3.4. Mirëmbajtja e ndërtesave administrative – afariste, çka është kjo “afariste” nuk e di, por në 2023 kanë qenë 1000€, kurse në 2024 janë 96.746€. A është gabim teknik, apo kanë ndryshuar rrethanat? Në “mirëmbajtjen rutinore” e kemi një rritje prej rreth 200.000€, çka është kjo? Sepse veç kodi i mirëmbajtjes rutinore është 423.617€. Drejtor, në raport me kontratat e lidhura, e kam bërë analizë vetëm një projekt. Kolektori i shtratit të lumit Hoçë e Madhe – Krushë e Madhe e kap vlerën prej 1.97milionë € dhe që duhet të përfundojë në 2027. Sipas KAB-it, deri në 2027 janë 1.17 milionë, do të thotë diku 800.000€ më pak në KAB, sesa kontrata që është lidhur. Si është nënshkruar deklarata e disponueshmërisë financiare, kur në KAB nuk ka para për tre vjet? A lejohet, a është në rregull? Ndoshta ndërkohë me ndonjë grant qeveritar, mirëpo në KAB nuk ka mbulueshmëri financiare dej në 2027 për këtë kontratë. Faleminderit për

këtë qasje konstruktive në raport me prezantimin. Kur marrim dhe i krahasojmë kontratat që janë lidhë në 2024, të cilat duhet të përfundohen deri në 2027 dhe kur e krahasojmë buxhetin për investime kapitale, në 2024 kanë qenë të mundshme të lidhen kontratat vetëm 4.15 milionë €, sepse aq ka buxhet deri në 2027. Në anën tjetër, janë lidhur kontrata rreth 11 milionë € ose 6 milionë më shumë sesa ka kapacitete financiare Komuna e Rahovecit deri në 2027. Si jeni duke e gjetur mundësinë e nënshkrimit të deklaratave të disponueshmërisë financiare, kur nuk ka mjete? Kjo gjendje na qon deri te raporti i ZKA-së për vonesën në implementim të projekteve, vonesë në pagesa të faturave etj.

**Afrim Limani:** Burim, nëse nuk kam mundur t'i shënoj të gjitha pyetjet, mund të bëjmë bisedë interaktive dhe të bisedojmë. Të hyrat për regjistrimin e automjeteve: Aty janë dy kode të ndryshme. Ndonjëherë punëtori që bën regjistrim mund t'ia huq dhe mund të ndodh që të shkon në kodin tjetër. Kur bëjmë krahasim me vitin e kaluar, janë gati të njëjta. Gjobat në trafik: Këtë vit janë më të mëdha sesa në vitin e kaluar dhe kjo i bie që policia ka qenë më efikase. Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit: Janë nga fondi burimor 21 dhe 22 dhe konkretisht janë shpenzimet e bartjes së nxënësve. Vlera e lartë e shpenzimeve këshillëdhënëse: Kryesisht janë pagesat për komitete që operojnë në komunën tonë. Shpenzimet kontraktuese tjera: Unë e kam një raport në mënyrë të detajuar, e para është mbikëqyrja e projekteve kapitale – 38.361€, AZHR – 11.500€, hartimi i projekteve – 30.274€, hartimi i projekteve për fermerë – 29.000€, ATK, trusti i pensioneve për konsulentë – 4000€, vaksinimi i qenve endacakë – 33.000€, hartimi i planit komunal për energji të qëndrueshme – 3820€, hartimi i planit lokal për biodiversitet dhe për cilësi të ajrit – 51.000€, rrënimi i objekteve pa leje – 32.000€, sinjalizimi horizontal dhe vertikal – 14.000€, dhe 3300€ është hartimi i planit komunal për energji. Pyetja tjetër ishte rreth shpenzimit të lartë të buxhetit për mirëmbajtje të ndërtesave afariste: Janë disa emërtime të reja, sepse ka ndryshuar plani kontabël dhe kjo mund të krijojë huti. Ne i kemi dy kontrata për punëtorët e pastrimit, një me administratën e komunës dhe një me administratën e QKMF-së. Mirëmbajtja rutinore ka të bëjë me pastrimin e rrugëve gjatë dy sezoneve dhe mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese. Rregullimi i shtratit të lumit Hoçë e Madhe. Ne e kemi pasur një kontratë më herët që e ka financuar Ministria e Infrastrukturës dhe ndërkohë është ndërprerë dhe ne pasi e fituam Grantin e Performancës, këtë vit i kemi ndarë 540.000€. Kjo nuk ka qenë në linjat buxhetore, sepse kontrata është lidhur pasi që është votuar buxheti dhe për vitin e ardhshëm duhet ta vendosim në planifikim të buxhetit. Vlera e projekteve kapitale që janë në projeksione buxhetore është më e vogël sesa mundësitë buxhetore: Të them sinqerisht, obligimet e Komunës së Rahovecit janë 20 milionë në total, 15 milionë për investimet kapitale dhe 5 milionë për mallra dhe shërbime, si dhe 546.000 për subvencione. Buxhetin me projeksione për tri vitet e ardhshme e kemi 19 milionë dhe matematikisht e mbulon buxhetin për investime kapitale dhe gjithashtu edhe për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

**Rasim Fazliu:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë! Dëshiroj të ndalem te tabela 1.2, të hyrat e rregullta të planifikuara dhe të realizuara në baza mujore, për vitet 2024/2023 dhe krahasimi i tyre. Drejtor, unë nuk do t'i përsëris gjërat që i tha Burimi, por më intereson kjo: Planifikimi i buxhetit për 2024 është bërë më i vogël, d.m.th shuma është më e vogël sesa realizimi i buxhetit në vitin 2023 dhe kjo pak është e çuditshme, sepse vazhdimisht duhet të bëjmë planifikim pak më të madh. Pra, pse është bërë planifikimi për vitin 2024 më i vogël sesa realizimi që është bërë në vitin 2023? Pyetja tjetër, është rreth tabelës 1.6, krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike për vitin 2024/2023: Më intereson që, tatimi në tokë për vitin 2024 është planifikuar 134.374€, ndërsa realizimi është bërë 4 fish më shumë. Më vjen mirë që realizimi është më i madh, por, pyetja është a ka pasur keqplanifikim, apo ku është çështja? Këto mjete a janë të gjitha për vitin 2024 dhe në fakt kur ka filluar që të paguhet tatimi në pronë, prej cilit vit? A janë të gjitha këto 417.626€ të realizuara në vitin 2024, apo ka edhe të vitit 2023? Tjetër, e kemi një dallim në dy tabela ku është i paraqitur tatimi në pronë. Këtu ku është krahasimi i të hyrave, kodi 40110, planifikimi për vitin 2024 është 634.015€, ndërsa kur dalim në tabelën tjetër, po për të njëjtin vit, planifikimi është 708.418€, pse është ky ndryshim?

**Afrim Limani:** Mësues, paraprakisht po ta jap një informatë bazë, që në fakt ta jep përgjigjen e pyetjes që e bëre. E vërtetë që ka dallime brenda vitit 2023/2024. Në prill gjithmonë na vjen një shkresë që ne duhet ta bëjmë planin e të hyrave vetanake për vitin aktual. Plani vjen i plotësuar që të hyrat tatimore janë kaq, të hyrat jotatimore kaq. Do të thotë që çdo gjë është e specifikuar nga departamenti i buxhetit. Tatimi në tokë këtu është i specifikuar, 417.000€, por kësaj

here i kemi ndarë, ndërsa tatimi në objekte është 576.000, që të dyja së bashku bëjnë 993.000€. Te pyetja tjetër, te planifikimi: Planifikimin e kemi përpjesëtuar me 12 muaj, që ka dalë vlera 59.000, ndërsa realizimi është bërë sipas muajve, në janar i kemi pasur 57.000€, në shkurt 35.000 dhe vlera më e lartë e inkasuar ka qenë 193.000 në prill.

#### **5. Shqyrtimi i raportit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2023:**

**Afrim Limani:** Ky është raporti i fundit që e kemi bërë gati për zbatimin e rekomandimeve për ZKA-në. Kemi mbajtur shumë takime, bashkë me komisionin për zbatimin e rekomandimeve dhe në bazë të konstatimit në cilësi të drejtorit, dhe kemi dalë në terren dhe konsideroj që ky raport nga 8 rekomandime besoj që plotësisht do të zbatohen 6 rekomandime dhe 2 pjesërisht.

#### **6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, P- 05864-0 dhe 05865-0, ZK – Rahovec: 11,23,50**

**Afrim Oruqi:** Faleminderit kryesues! Bëhet fjalë për një vendim, për dhënien e një prone me qira për 15 vjet. Prona është në Rahovec, janë dy parcela: P- 05864-0 dhe 05865-0. Parcela e parë i ka 20 ari e 31m<sup>2</sup> dhe parcela e dytë i ka 3 ari e 20m<sup>2</sup>. Parcelat janë në kufij me njëra-tjetrën. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim është kultivimi i bujqësisë dhe i blegtorisë. **Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! A kemi pyetje? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 18 vota “për”, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, votohet pika e gjashtë.

#### **7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës P- 05864-0 dhe 05865-0 ZK Rahovec:**

**Afrim Oruqi:** Kemi vendim për formim të komisionit, i cili vlerëson procedurat për parcelat në fjalë. Komisioni përbëhet prej 5 anëtarëve.

**Sinan Kryeziu:** AAK, propozojmë Feriz Thaqin.

**Edonë Kryeziu:** LDK, nuk kemi propozim.

**Merisë Sharku:** LVV, nuk kemi propozim.

**Bejtullah Deliu:** PDK, nuk kemi propozim.

**Feriz Thaqi:** AAK, atëherë nëse ka hapësirë, propozoj Afrim Berishën.

**Kryesuesi:** Faleminderit, atëherë nga kuvendi janë Feriz Thaqi dhe Afrim Berisha, dy do t'i kemi nga ekzekutivi dhe një nga sektori joqeveritar. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Konstatohet që me 16 vota “për”, 1 abstenim dhe asnjë kundër, votohet përbërja e komisionit.

#### **8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, P-00597-6, ZK – Xërxë:**

**Afrim Oruqi:** Bëhet fjalë për parcelën në zone kadastrale në Xërxë me numër 597-6, me sipërfaqe të përgjithshme 21 ari e 95 m<sup>2</sup> e klasit të pestë. Qëllimi ka të bëjë me kultivimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Ju kërkohet që të marrim vendim, që këtë parcelë ta japim për 15 vjet. Bazuar në PZhK, kjo është zonë ndërtimore.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! A kemi pyetje? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 16 vota “për”, 2 kundër dhe 1 abstenim, votohet pika e tetë e rendit të ditës.

#### **9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës P-00597-6, ZK – Xërxë:**

**Afrim Oruqi:** Kemi vendim për formim të komisionit, i cili vlerëson procedurat për parcelat në fjalë. Komisioni përbëhet prej 5 anëtarëve, 2 prej ekzekutivit, 2 prej kuvendit dhe 1 prej shoqërisë civile.

**Hasan Përboqi:** AAK, propozojmë Sinan Kryeziun.

**Fahrije Lushi:** LDK, propozojmë Lirigzon Kastratin.

**Merisë Sharku:** LVV, nuk kemi propozim.

**Sejfullah Sejfullahu:** PDK, nuk kemi propozim.

**Kryesuesi:** Faleminderit, atëherë nga kuvendi janë Sinan Kryeziu dhe Lirigzon Kastrati, dy do t'i kemi nga ekzekutivi dhe një nga sektori joqeveritar. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Konstatohet që me 19 vota “për”, 2 kundër dhe asnjë abstenim, votohet përbërja e komisionit.

## **10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për këmbimin e pronave komunale me pronat e institucionit qendër:**

**Afrim Oruqi:** Faleminderit kryesues! Bazuar në kërkesat e ministrive të përmendura më poshtë, marrim vendim që t'i japim pronat e komunës në këto sipërfaqe që i keni të shkruara, në këto dy zona Ministrisë së Ekonomisë për 34 vjet, duke mos e ndërruar titullarin. Qëllimi i vetëm është bashkimi i parcelave dhe fillimi i implementimit të projektit për parkun solar. Kërkoj nga sekretariati që ta tërheq nenin 3 në këtë material.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! A kemi pyetje? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 19 vota "për", asnjë kundër dhe asnjë abstenim, votohet pika e dhjetë e rendit të ditës.

## **11. Shqyrtimi i raportit të punës të kuvendit komunal për vitin 2024:**

**Skender Hamza:** Përshëndetje kryesues! Përshëndetje nënkryetar, ekzekutiv dhe anëtarë të kuvendit! Me kënaqësi po e paraqes raportin 12-mujor të punës së kuvendit të komunës së Rahovecit për vitin 2024. Raporti ka për qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënien, karshi qytetarëve të komunës. Kuvendi i komunës i ka të themeluara 5 komitete, 2 janë obligative, 2 konsultative dhe gjithashtu e ka të themeluar edhe KKSBB-në. Kuvendi i komunës së Rahovecit gjatë vitit 2024 i ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta, 2 solemne dhe 1 mbledhje përkujtimore. KPF-ja po ashtu i ka mbajtur 12 mbledhje, Komiteti për Komunitete - 6 mbledhje, Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizuara – 6 mbledhje, Komiteti për Shëndetësi – 6 mbledhje dhe Komiteti për Arsimit - asnjë mbledhje. Të gjitha mbledhjet e kuvendit dhe të komiteteve kanë qenë të hapura për publikun. Në mbledhjet e rregullta gjatë vitit 2024 janë shqyrtuar 141 pika të rendit dhe janë aprovuar 77 vendime, 20 raporte dhe 20 informata. Ne, si sekretari e Kuvendit, i kemi dërguar në MAPL 77 akte që janë marrë nga kuvendi i komunës së Rahovecit dhe numri i konfirmimit të ligjshmërisë është 58, si dhe nga këto 58, 10 vendime janë rishqyrtuar, duke u bazuar në rekomandimet e MAPL-së.

**Sejfullah Sejfullahu:** Faleminderit për informatën z. Hamza. E para, a jemi përmirësuar në raport me MAPL-në të ligjshmëritë në raport me vitin paraprak? E dyta, a mund ta bëjmë ndonjë bashkëpunim me ndonjë komunë tjetër që të realizojmë ndonjë vizitë studimore, sepse ka 3 vite që je duke premtuar kryesues.

**Lirigzon Kastrati:** Vetëm një përmirësim, Komiteti për Shëndetësi i ka mbajtur 5 mbledhje.

**Skender Hamza:** Faleminderit Lirigzon! Sa i përket vendimeve, vitin e kaluar kemi pasur më shumë vendime të aprovuara në kuvend, sesa në këtë vit. Moskonfirmimi i ligjshmërisë në afatet kohore nga MAPL mbetet sfida e jona si sekretari. Tani është aprovuar një ligj i ri, ku afati për konfirmim është bërë nga 15 ditë, në 30 ditë.

## **12. Shqyrtimi i informatës rreth punës së KKSBB-së për vitin 2024:**

**Nënkryetari:** Para vetes e keni informatën. Me rregull janë 6 takime në vit, sivjet ne i kemi mbajtur 8, një prej tyre ka qenë urgjente. Kryesisht diskutohet siguria në territorin e komunës së Rahovecit.

## **13. Shqyrtimi i Raportit të punës të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2024:**

**Kryesuesi:** Atëherë, nëse keni të shtoni diçka rreth kësaj pike? Nëse jo, vazhdojmë me pikën tjetër.

## **14. Shqyrtimi i raportit vjetor rreth punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024:**

**Bajram Morina:** Përshëndetje kryesues, nënkryetar, drejtorë, anëtarë të asamblesë. Raporti është pasqyrim i aktiviteteve dhe angazhimeve të Komitetit për Komunitete, janar-dhjetor 2024. Fokusi kryesor i këtij komiteti është përmirësimi i situatës për komunitetin joshumicë në komunën e Rahovecit dhe fuqizimin e pozitës së tyre në të gjitha fushat. Synimi kryesor gjatë vitit 2024 përfshin: Përmirësimin e gjendjes ekonomike, përmirësimin e infrastrukturës, zhvillimin e aktiviteteve edukative dhe sportive dhe shumë fushata sensibilizuese. Komiteti për Komunitete ka mbajtur 6 takime gjatë vitit 2024. Janë realizuar vizita të ndryshme në shkolla dhe vizita në lagje ku jetojnë komuniteti joshumicë, për të parë nga afër gjendjen në infrastrukturë, ndriçim, kanalizim dhe në fusha të tjera jetike. Pjesëmarrja aktive e anëtarëve të komitetit dhe asambleistëve, ka ndihmuar në përcaktimin e prioriteteve për veprime të menjëhershme në fushën e arsimit. Janë të pasqyruara edhe përmirësimet për aktivitetet kulturore të komunitetit joshumicë. Komiteti për Komunitet ka marrë pjesë në trajnime dhe tryeza të ndryshme, duke përfshirë ftesa nga organizatat ndërkombëtare, qendrore dhe lokale. Raportin e keni në emailat tuaja dhe për çdo pyetje jam këtu për t'u përgjigjur.

## **15. Shqyrtimi i Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025:**

**Nënkryetari:** Të nderuar asambleistë, para vetes e keni planin e punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025. Ky plan duhet të kalohet formalisht përmes asamblesë. E falënderoj Lamin dhe e përgëzoj për raportin.



**Kryesuesi:** Faleminderit nënkryetar! Nëse dikush nuk ka ndonjë gjë rreth kësaj pike, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me 22 vota “për” votohet edhe pika e 15-të.

**16. Shqyrtimi i raportit të punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2024:**

**Lirigzon Kastrati:** Faleminderit kryesues! Kryesuese e komiteti është Vlora Vuçitërna, por në mungesë të saj, si anëtar i këtij komiteti më lejoni që para kuvendit komunal, si dhe para qytetarëve ta bëj prezantimin e raportit vjetër të Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2024. Anëtarë të këtij komiteti janë: Vlora Vuçitërna, kryesuese – LVV, Shukrije Himaj – AAK, unë Lirigzon Kastrati – LDK, Zana Çmega nga shoqëria civile dhe Armir Vuçitërna – PDK. Në pajtim me udhëzimin administrativ Nr. 06/2011 për procedurën e themelimit dhe përbërjen e komiteteve të përhershme dhe të komiteteve tjera të komunës së Rahovecit, në pajtim me pikën 16, paragrafit 3 të këtij udhëzimi, kuvendit të komunës ia dorëzojmë raportin vjetor të punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale. Qëllimi i këtij komiteti është përkujdesja dhe zbatimi i shërbimeve të kujdesit parësor-shëndetësor në komunën tonë, duke rregulluar mirëqenien e qytetarëve. Plani i punës për vitin 2024 ka qenë ky: Vizitë në QMF në fshatin Opterushë, në AMF në Brestoc, vizitë në QMF në Fortesë, në Drenoc, takim me u.d. të drejtorit të QKMF-së, drejtorin e QPS-së dhe drejtorin e Hendikosit në Rahovec. Kemi vizituar Qendrën për Punë Sociale dhe Shtëpinë e të Moshuarve. Gjithsej për vitin 2024 kemi realizuar pesë mbledhje. Në Drenoc kemi kërkuar që edhe atje të ketë një barnatore, me barna esenciale dhe barna të tjera. Raportin e keni në emailat tuaj dhe për çdo pyetje jam këtu për t’u përgjigjur.

**17. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuar për vitin 2024:**

**Almedina Jaha:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, unë jam Almedina Jaha, kryesuese e Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuar në komunën e Rahovecit. Në përputhje me parimet të deklaratës së përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut është e qartë së të drejtat e njeriut dhe të drejtat e individëve janë të patjetërsueshme dhe të barabarta për të gjithë. Ky parim është themel mbi të cilin komiteti ynë ka punuar gjatë vitit 2024. Në komunën e Rahovecit jetojnë rreth 1006 persona me aftësi të kufizuara. Për këtë kategori mbetet i rëndësishëm sigurimi i shërbimeve shëndetësore, i cili kërkon angazhim të vazhdueshëm për t’i mundësuar atyre shërbime të barabarta dhe të përshtatshme. Gjatë vitit 2024 kemi organizuar 6 mbledhje të rregullta. Raportin e keni në emailat tuaj dhe për çdo pyetje jam këtu për t’u përgjigjur.

**18. Vendimi për formimin e komisionit përzgjedhës për plotësim-ndryshimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara:**

**Kryesuesi:** Të nderuar anëtarë, kemi ardhur te pika e parafundit. Kjo pikë ka të bëjë me formimin e komisionit përzgjedhës për ndryshim-plotësimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.

**Hasan Përboqi:** AAK, ne propozojmë asambleisten Florida Bajraktari.

**Burim Krasniqi:** LDK, nuk kemi propozim.

**Sejfullah Sejfullahu:** PDK, nuk kemi propozim.

**Leonard Morina:** LVV, ne propozojmë Merisa Sharkun.

**Kryesuesi:** Për moment i kemi dy propozime, por na duhet edhe një nga kuvendi.

**Fahrije Lushi:** LDK, atëherë propozojmë Lirigzon Kastratin.

**Kryesuesi:** Faleminderit, atëherë nga kuvendi i kemi tre emra, Florida Bajraktari AAK, Merisa Sharku LVV dhe Lirigzon Kastrati LDK, si dhe nga ekzekutivi Besmirë Bytyqi. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 22 vota “për”, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, votohet përbërja e komisionit.

**Kryesuesi:** Të nderuar kuvendarë, në emailt tuaj ka ardhur edhe një pikë që ka të bëjë me miratimin e planit të punës së këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, janar-dhjetor 2025. Në preambulë është bërë një gabim teknik dhe është përmirësuar. Kush është “për”?... Kundër?... Me 22 vota “për”, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, votohet edhe pika e fundit. Ju falënderoj për vëmendjen dhe shihemi në mbledhjet e radhës.

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi



